



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 07 prill 2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa dhe Naim Fetahu.

Munguan: Besnik Bislimi, Valdete Bajrami dhe Duda Balje

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision dhe Saranda Kaçi praktikante.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Sanije Berisha OSBE, dhe Qendresa Mulaj – ZAP

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, Zv. kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 13.03.2015;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2013;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës mbi aktivitetet e Policisë së Trafikut dhe sigurisë në Trafikun Rrugor;
5. Të ndryshme;

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

zv. Kryetari - Konstatoi që aprovohet rendi i ditës me ndryshime, ku pika 4 e rendit të ditës hiqet për diskutim për shkak se Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk e ka konfirmuar pjesëmarrjen.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 13.03.2015

zv. Kryetari –konstatoi që aprovohet miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13.03.2015 njëzëri nga ana e deputetëve të pranishëm.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2013;

zv. Kryetari – njoftoi deputetët se Kryetari i komisionit dhe administrata e komisionit ka përgatitur një numër të rekomandimeve për sa i përket raportit vjetor të auditimit për vitin 2013,

të njëjtat i keni në materialet e juaja për takimin e sotëm. Pra, para vetes kemi gjithsejtë 11 rekomandime, ku tri nga këto rekomandime do ti analizojmë dhe nëse mendoni se janë në rregull atëherë do ti adresojmë për seancë plenare. Bëhet fjalë për rekomandimin 5, 6 dhe 8 të cilët po ju lexojë tani. Qeveria e Republikës së Kosovës të sigurojë një mekanizëm efektiv të monitorimit të performancës së ndërmarrjeve publike. Në veçanti rekomandojmë që Ministria e Zhvillimit Ekonomik të përcaktojë saktë indikatorët e performancës së këtyre ndërmarrjeve, dhe njëkohësisht të garantojë se kompensimi i anëtarëve të bordit është konformë rregullave në fuqi dhe rezultateve të kompanisë. Me këtë hapi diskutimin.

Bali Muharremaj- me sa Unë jam i informuar, kryetari i komisionit z. Bislimi ka dhënë tri rekomandime për raportin vjetor të auditimit për vitin 2013, NE do i shqyrtojmë tani dhe nëse votohen nga deputetët atëherë do i adresojmë për seancë plenare.

Hajdar Beqa - unë konsideroj se sa i përket formës së matjes së performancës kjo qeshje është e rregulluar me ligjet në fuqi, ndërsa pjesa e dytë ku ka të bëjë me pagesën e anëtarëve të bordeve, mendoje se në një formë kjo është jashtë kompetencave të komisionit tonë. Sipas mendimit tim rekomandimi numër 6 është i panevojshëm dhe si i tillë duhet të fshihet.

Synavere Rysha- Unë në veçanti mendoje se paragrafi në mes i rekomandimit numër 6 është i qëlluar ngase Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet ti përcaktojë qartë indikatorët matës të performancës për ndërmarrjet publike. Po ashtu sa i përket qeshjes së pagesës së anëtarëve të Bordeve kjo në fakt duhet trajtuar edhe nga Kuvendi për shkak të dallimeve të mëdha në lartësinë e pagave të vetë anëtarëve të bordeve. Sipas meje lartësia e pagesës së anëtarëve të Bordeve duhet të caktohet në bazë të performancës që tregon ndërmarrja publike.

Adem Grabovi – Unë mendoje se rekomandimi numër 6 i propozuar nga z. Bislimi është i qëlluar mirëpo, performanca e ndërmarrjeve publike është e rregulluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, kjo në fakt është përgjegjësi e Njesisë për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Konstatimet e Auditorit të Përgjithshëm NE duhet ti përcjellim se si po adreson ato dhe apo adresohen në mënyrë të duhur.

Hajdar Beqa- Unë prapë dëshiroj të theksoi se kategorizimi i ndërmarrjeve publike ka qenë i rregulluar në tri nivele, qendrore, lokale dhe regjionale dhe se pagesat e anëtarëve të Bordeve

janë bërë sipas vendimit të Qeverisë dhe kategorizimit të lartcekur. Po ashtu MZHE përmes NJPMNP vlerëson Përformancën e Ndërmarrjeve Publike. Prandaj mendoje se ky rekomandim është i panevojshëm.

Adem Grabovci - Unë mendoje se pjesa që ka të bëjë me nivelimin e pagave të anëtarëve të Bordeve duhet të nivelohen, sepse ka diferenca të shumta ndërmjet anëtareve të Bordeve në Ndërmarrjet Publike.

Synavere Rysha- me ju thënë të drejtën Unë personalisht deri tani nuk kam marre ndonjë raport nga ndërmarrjet publike që flet për performancën e ndërmarrjeve publike të shprehur në numra.

zv. Kryetari- propozoi që rekomandimi numër 6 të ndahet në dy pjesë, pjesa e parë që ka të bëjë me performancën e ndërmarrjeve publike dhe pjesa e dytë që ka të bëjë me nivelimin e pagave të anëtareve të Bordeve.

Hajdar Beqa- Unë prapë mendoje se NJPMNP është e themeluar për këtë qëllim dhe se ndarja e fondeve për ndërmarrjet publike bëhen në pajtim të plotë me NJPMNP. Po ashtu ka laramani ndërmjet pagave të anëtareve të Bordeve dhe të punësuarve në ndërmarrje publike. Rekomandimi i dhënë për këtë çështje është i panevojshëm.

zv. Kryetari- Vendimet e Bordeve të ndërmarrjeve publike duhet doemos ti aprovon Qeveria, megjithatë NJPMNP i përcjell punën e ndërmarrjeve publike. Megjithatë unë do i propozoi stafit të KMFP që të harmonizojë këtë rekomandim varësisht prej diskutimeve të dala nga ky takim. Po ashtu në rekomandimin numër 5 është dhënë një propozim sipas të cilit Ministria e Financave të sigurojë një rishikim serioz të planit të të hyrave buxhetore, për të garantuar ekzekutimin e plotë të projekteve të aprovuara me Ligjin për Buxhetin e vitit aktual, po ashtu edhe respektimin e rregullës fiskale. Cili është mendimi i juaj për këtë.

Naim Fetahu – bazuar në rekomandimin e propozuar në pikën 5 të raportit të paraqitur me të cilin është kërkuar rishikimi i planit të të hyrave buxhetore, mendoje se është e panevojshme dhe e panevojshme, ngase kjo është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së Financave. Po ashtu respektimi i rregullës fiskale është përgjegjësi e dhënë me ligjet në fuqi gjegjësisht LMFP dhe Ligji i Buxhetit.

zv. Kryetari- atëherë bazuar në qëndrimet e deputetëve, që janë të interesuar ta fshijnë këtë rekomandim, i propozojmë administratës së KMFP ta bëjë fshirjen e rekomandimit numër 5. Po ashtu në diskutim është edhe rekomandimi numër 8 i cili theksonte se Ministria e Administratës Publike të sigurojë që emërimet, gradimet dhe promovimet e zyrtareve publik të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritokracisë, në mënyrë që shkeljet e evidentuara të mos përsëriten sërish. Me këtë hapi diskutimin.

Adem Grabovci – mendoj se ky rekomandim është i panevojshëm, se MAP nuk është subjekt politik po është institucion i cili punon në bazë të rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Bali Muharremaj- po ashtu mendoje se nuk ka nevojë të futet ky rekomandim sepse është i panevojshëm.

zv. Kryetari-sipas kësaj që po diskutojmë mendoje se edhe rekomandimi numër 8 duhet të fshihet, për këtë po e hodhi në votim, me shumicë votash rekomandimi numër 8 fshihet.

zv. Kryetari- i hodhi në votim rekomandimet e KMFP për votim dhe propozoje të njëjtat të adresohen për seancë plenare, me shumicë votash rekomandimet u vendos që rekomandimet të shkojnë në seancë plenare.

Përfundim

Të gjithë deputetët u pajtuan që rekomandimet bashkë me raportin vjetor të Auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të adresohen në diskutim në Seance Plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

zv. Kryetari i parë i Komisionit

Ali Sadriu